

STATISTIKAT E PARASË DHE TË BANKAVE : ARRITJE DHE
SFIDA PËR TË ARDHMEN

Gramoz Kolasi

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

STATISTIKAT E PARASË DHE TË BANKAVE:
ARRITJE DHE SFIDA PËR TË ARDHMEN

1. NË VEND TË HYRJES

Jo shumë kohë më parë, rreth marsit të vitit 1992, për herë të parë na ra një dorë një skedar i thjeshtë lotusi ku në mënyrë të përmbledhur pasqyroheshin disa seri të dhënash emërtimi i të cilave, jo vetëm nga gjuha e huaj në të cilën ishin shkruar, na tingëlloi tërësisht i largët dhe pse jo disi mistik. U çuditëm disi pasi në vend të grupimeve standarde të një bilanci kontabël, pamë një riororganizim të ri të dhënash ku e rëndësishme ishte që nga totali të:

- dallohej ajo pjesë e të drejtave dhe detyrimeve që të huajt kishin ndaj Shqipërisë;
- dihej saktë se ç'pjesë i takonte qeverisë, ndërmarrjeve publike, sektorit privat, individëve etj.;
- klasifikoheshin instrumentet financiare sipas aftësisë, që ato kishin për t'u shndërruar në para të gatshme;
- veçoheshin llogari të tëra, të cilat nga këndvështrimi statistikor nuk kishin rëndësi të dorës së parë, e për rrjedhim ato mund të klasifikoheshin thjesht si "zëra të tjera".
- etj..

Kjo retrospektivë është e shkurtër, por e mjaftueshme për të shprehur në mënyrë të saktë situatën, që mbizotëronte në momentin e themelimit të Bankës së Shqipërisë si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Gjithësesi, sot, tetë vjet më pas, shpreh bindjen time, se një nga sfidat e Bankës së Shqipërisë, ajo për hartimin dhe publikimin e një grupi statistikor të dhënash të parasë dhe të bankave, sipas standardit të Statistikave Financiare Ndërkombëtare (IFS), tashmë i takon të shkuarës.

Pikërisht, në fushën e statistikës gjejmë edhe dy nga kulmet e ecurisë së Bankës së Shqipërisë gjatë kësaj periudhe. I pari daton me shtatorin e vitit 1996, kur falë statistikave të plota dhe të besueshme monetare dhe të bankave, ndërtuar nga Banka e Shqipërisë, FMN-ja prezantoi faqen e Shqipërisë në IFS dhe i dyti lidhet me prezantimin e faqes së Shqipërisë në Sistemin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave ose siç njihet ndryshe GDDS.

Kam përshtypjen se pranimi i Shqipërisë si vend pilot nuk ishte i rastësishëm, por fryt i punës dhe i seriozitetit të treguar nga Banka e Shqipërisë. Tashmë në Bankën e Shqipërisë, "gjuha ndërkombëtare" e statistikave ka fituar të drejtën e qytetarisë. Ajo na bën të gjithëve të ndjehemi pjesëtarë me të drejta të barabarta në botën e madhe e të respektuar të statistikës. Më shumë se çdo gjë tjetër; më shumë se sa përkushtim, studim, kulturë e përgjithshme dhe inteligjencë, ajo që ne kemi arritur të bëjmë këta tetë vjet, është dashuri për punën dhe përgjegjshmëri kolektive për çdo fletë letër të shkruar në emrin e nderuar të Bankës së Shqipërisë.

2. NGA GJENDJA E PARË MONETARE DERI TEK PREZANTIMI NË GDDS

Ndryshe nga institucionet e tjera administrative, të cilat ligjërisht duhet të prodhojnë një grup të caktuar statistikor, detyra e Bankës së Shqipërisë ishte diçka më e thjeshtë dhe kjo për disa arsye, ku në mënyrë të veçantë bien në sy asistenca e parreshtur e Departamentit të Statistikave në FMN si dhe serioziteti i treguar nga të gjitha bankat tregtare pa bërë dallim midis tyre si nga "mosha" ashtu dhe nga forma e pronësisë. Faktorë të tjerë mund të përmenden:

- numri i pakët i bankave tregtare në momentin e krijimit të sistemit bankar me dy nivele;
- e drejta ligjore e Bankës së Shqipërisë për të licencuar bankat e nivelit të dytë;
- angazhimi i pothuaj të njëjtit personel përgjatë gjithë periudhës që i referohemi;
- trainimi intensiv i të gjithë personelit të angazhuar me hartimin e statistikave.

Pozita relativisht komode e Bankës së Shqipërisë, bëri që boshllëku statistikor në këtë fushë të kapërcehej shpejt. Fillimisht si produkt i gatshëm i servitur nga misionet e asistencës së FMN-së, me kalimin e kohës në mënyrë graduale u arrit hartimi nga ana e Departamentit të Politikës Monetare i dokumenteve statistikore të tilla si Llogaritë e Autoritetit Monetar¹, Llogaritë e Bankave

¹ Autoriteti monetar është një koncept, që i referohet aktivitetit që: (1) siguron dhe menaxhon emisionin e parasë, (2) menaxhon rezervat ndërkombëtare të vendit, (3) formulon dhe mban politikën monetare, (4) rregullon dhe mbikëqyr institucionet financiare, (5) vepron si agjent fiskal i qeverisë dhe (6) vepron si bankier i bankave. Në rastin e Shqipërisë të gjitha këto funksione kryhen nga Banka e Shqipërisë. Ndryshimi ndërmjet llogarive të autoritetit monetar dhe llogarive analitike të bilanci kontabël qëndron në mënyrë të klasifikimit të të dhënave dhe të trajtimit të llogarive, që kanë të bëjnë me lidhjet midis Bankës së Shqipërisë dhe Fondit Monetar.

Paradepozituese² dhe të Gjendjes Monetare³.

Përpilimi i statistikave të mësipërme, që nga ai moment e deri në ditët tona, ka përshkuar një rrugë të gjatë, e cila mund të kuptohet duke analizuar një për një çështjet kryesore, që kanë të bëjnë me hartimin dhe publikimin e SMB-ve.

2.1 SEKTORIZIMI I EKONOMISË DHE KATEGORIZIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE

Sektorizimi i ekonomisë është jo vetëm hapi i parë i domosdoshëm, por edhe një element mjaft i rëndësishëm në procesin e përpilimit të statistikave. Kjo për arsyen e thjeshtë se analiza ekonomike bëhet më e plotë, vendimmarrësit kuptojnë se si burimet financiare lëvizin në ekonomi dhe shumë lehtë mund të krahasosh pozicionin tënd me atë të vendeve të tjera. Në rastin e Shqipërisë, sektorizimi i ekonomisë, teorikisht, ka qenë një çështje relativisht e lehtë ndërkohë që në praktikë ky problem paraqitet më kompleks.

Vështirësia e parë ka qëndruar në aplikimin e saktë të **kriterit të rezidencës**. Që në fillim u pranua se klasifikimi i aktiveve dhe i pasiveve, në të huaja dhe të brendshme, do të bazohej në përcaktimin e bërë në manualin e pestë të bilancit të pagesave (përgatitur nga FMN) sipas të cilit të gjitha “njësitë institucionale të cilat e kanë qendrën e interesit ekonomik⁴ në një territor ekonomik të një vendi” konsiderohen rezidentë të atij vendi. Problemet e përcaktimit të saktë të kriterit të rezidencës njihen dhe nga vetë metodologjia, ku përmendim punëtorët e huaj, organizatat ndërkombëtare, projektet multinacionale etj..

Në rastin e Shqipërisë, vështirësitë qëndronin në përcaktimin e statusit të emigrantëve shqiptarë dhe në konfuzionin, që krijoi legjislacioni i tatimeve sipas të cilit koha e qëndrimit shkurtohej në 180 ditë. Aktualisht, bankat tregtare pretendojnë se e kanë të pamundur identifikimin e saktë të dërguesve nëse janë rezidentë apo jo (emigrantë apo punonjës sezonalë). E për këtë arsye të gjitha dërgesat nga shqiptarët jashtë konsiderohen si dërgesa nga jorezidentë. Kontradikta, në dukje, midis manualit të bilancit të pagesave dhe legjislacionit tatimor u zgjidh përfundimisht në shkurt 1999, kur të gjitha bankave tregtare ju bë e qartë se, nga pikëpamja statistikore, kriteri i rezidencës merr parasysh vetëm një periudhë njëvjeçare qëndrimi. Ky problem duket i kapërcyer sidomos në faktin që tashmë është unifikuar si koncept vlerësimi nga të gjitha institucionet e interesuara (Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, bankat tregtare, INSTAT-i, etj.).

Që në vitin 1992 fokusi i SMB-ve identifikoi disa sektorë të cilët, pavarësisht nga emërtimi, kam përshtypjen se në tërësi mbulonin të gjithë ekonominë e brendshme. Vitet që pasuan, në përgjithësi, nuk kanë shënuar ndonjë ndryshim të madh dhe në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2000, sektorizimi i ekonomisë regjistronte:

Sektorizimi i ekonomisë shqiptare			
1992	1999	Manuali i SMB-ve	Manuali i ri i SMB-ve
(a)	(b)	(c)	(d)
Qeveria	Qeveria	Qeveria qendrore	Qeveria e përgjithshme
		Qeveria qendrore	Qeveria qendrore
		Qeveria lokale	Qeveria lokale
Institucionet financiare	Institucionet financiare	Institucionet financiare	Kooperatatat financiare

² Bankat paradepozituese janë të gjitha ato banka dhe institucione financiare (përfshijtur bankën qendrore) që pranojnë detyrime në formën e depozitave të transferueshme me anë të çekut, ose që mund të përdoren drejtpërdrejt në kryerjen e pagesave. Të gjitha bankat e nivelit të dytë në Shqipëri klasifikohen si banka para depozituese, pasi ato, pa përjashtim, kanë detyrime në formën e llogarive korente.

³ Gjendja monetare është një paraqitje statistikore sipas një standardi ndërkombëtar klasifikimi i të dhënave të bilancit kontabël të bankës qendrore dhe të bilanceve kontabël të të gjitha bankave tregtare. Standardi i klasifikimit është përgatitur nga FMN dhe është një nga produktet finale të statistikave të parasë dhe të bankave. Aktualisht, nën të ashtuquajturën statistika të parasë dhe të bankave përfshihen tre produkte kryesore: paraqitja e llogarive të bankës qendrore, paraqitja e llogarive të bankave paradepozituese dhe ajo, që përmendëm më sipër, gjendja monetare.

⁴ Interesi ekonomik përcaktohet nga a) vendbanimi; b) vendi i aktivitetit të prodhimit për një periudhë të gjatë ose të papërcaktuar kohe, përgjithësisht njëvjeçare; c) ekzistenca e pikësnyimit për një aktivitet prodhues afatgjatë.

Nd.jet & fermat shtetërore	Nd.je publike jofinanciare	Nd.je publike jofinanciare	Spektori i korporatave jofinanciare
Nd.je të përbashkëta	Spektori privat	Nd/je private jofinanciare	Korporata private
Spektori privat		Individët	Korporata publike
			Institucione jofitimprurëse që u shërbejnë individëve
Individët	Individët		Individët
Nënspektori financiarë			
(a)	(b)	(c)	(d)
Autoriteti monetar	Banka qendrore	Banka qendrore	Banka qendrore
BPD	BPD	BPD	Korporata paradepozituese
	Të tjera jo-BPD	Të tjera institucione bankare	Të tjera korporata paradepozituese
		Të tjera institucione financiare	Kompani sigurimesh dhe fonde pensionesh
			Të tjerë ndërmjetës financiarë
			Ndihmësa financiarë

Siç shihet nga tabela e mësipërme dallimet midis sektorizimit të ekonomisë me manualin e përpilimit të SMB-ve janë me ndryshime të vogla. Ndërkohë në tabelën e dytë vihen re ndryshime më të mëdha, të cilat në fund të fundit pasqyrojnë ecurinë e tregjeve në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit. Nga një vështrim më i kujdesshëm i të dyja tabelave do të veçonim:

- Ashtu si në vitin 1992, edhe sot e kësaj dite sektori “qeveria” përfaqëson të dyja llojet e qeverisjes si atë qendrore, ashtu dhe atë lokale. Ky problem është i njohur dhe lidhet me faktin e mungesës së një buxheti të pavarur nga qeveria qendrore për grumbullimin e taksave. Për atë kohë sa pushteti vendor do të vazhdojë të mbulojë shpenzimet e veta nga buxheti qendror, për atë kohë do të vazhdojë klasifikimi si një sektor i vetëm.
- Ndryshe nga fillimi i tranzicionit, koncepti i pronës shtetërore është zëvendësuar me konceptin e administrimit publik të një ndërmarrjeje, korporate, institucioni etj.. Nga ana tjetër, mos harrojmë se fermat shtetërore së bashku me kooperativat bujqësore i përkasin historisë. Blerja, që i bëri qeveria detyrimeve të tyre, në vitin 1993 bëri që emërtimi i këtij sektori të ndryshonte në : ndërmarrje publike jofinanciare.
- Ndërmarrjet e përbashkëta fillimisht u evidentuan si një sektor ekonomik më vete për vetë rëndësinë që ju dha atyre (më shumë nisur nga prania e bashkimeve të ndërmarrjeve pronë e shtetit me ndërmarrje private të huaja). Me kalimin e kohës, bazuar dhe në faktin që asnjëherë ky grup ndërmarrjesh nuk u bë një zë i rëndësishëm në zhvillimin e vendit, u pa e udhës që edhe këto njësi, në varësi të pronësisë mbi to, të regjistroheshin në sektoret përkatës: privat apo publik.
- Institucionet financiare janë një sektor jetik për ekzistencën e suksesshme të çdo ekonomie. Është kjo arsyeja që dhe në manualin e FMN-së, ky sektor është ndarë në nënspektore të tjerë, të cilët fatkeqësisht akoma vazhdojnë t’i mungojnë Shqipërisë. Nënspektorizimi i thjeshtë, që i bëhet sektorit financiar, lidhet kryesisht me praninë e vetme të sistemit bankar, edhe pse tashmë janë krijuar edhe dy operatorë privatë në fushën e sigurimeve⁵. Ky lloj statusi i pandryshuar i sektorit financiar, në kushtet e mungesës së tregut të kapitaleve dhe të letrave me vlerë, bën që edhe klasifikimi të jetë i thjeshtë në bankë qendrore dhe banka paradepozituese.

⁵ Në 31 dhjetor të vitit 1999, sektori financiar në Shqipëri përmblidhte sistemin bankar dhe sektorin financiar jobankar. Sistemi bankar përfshinte Bankën e Shqipërisë së bashku me 5 degët e saj, 10 banka tregtare dhe 6 shoqëri kursim – krediti. Ndërkohë, sektori financiar jobankar përmblidhte Bursën e Tiranës, Agjencinë e Mbledhjes së Kredive, tre fonde investimesh, tre shoqëri kursimesh dhe 15 zyra këmbimesh valutore.

- Aktualisht, tash së fundi, FMN-ja ka përgatitur dhe ka publikuar një format të ri të përgatitjes së Statistikave Monetare dhe Financiare (SMF). Mënyra e re e sektorizimit evidentohet në kolonën (d), dhe siç mund të kuptohet lehtë këto ndryshime, më së shumti, janë diktuar nga zhvillimet e kohëve të fundit në tregjet ndërkombëtare si dhe nga globalizimi gjithnjë e në rritje i tyre. Nga këndvështrimi i Shqipërisë, sektorizimi, sidomos ai i sektorit financiar, të paktën dhe për një periudhë afatmesme, do të vazhdojë të jetë po ky. Zgjerimi i fokusit të monitorimit statistikor nga ana e Bankës së Shqipërisë mbi institucione të tilla si shoqëri sigurimesh, skema pensionesh, fonde investimesh, të tjerë ndërmjetës dhe ndihmës financiarë, para së gjithash do të kërkonte rregullime ligjore si dhe sqarime të tjera, ku përparësi do të kishte formati i raportimit në përputhje me SMF-e.
- Aktualisht, Banka e Shqipërisë përgatit dhe të gjithë grupin statistikor në formatin e kërkuar nga manuali i ri i hartimit të SMF-ve, i cili, aktualisht, është i vlefshëm vetëm për përdorim të Bankës dhe të FMN-së. Edhe shpjeguesit metodologjikë të publikuar nga ana e FMN-së në faqen e Shqipërisë në GDDS, janë përgatitur në përputhje me manualin e ri të përpilimit të SMF-ve.

2.2 KLASIFIKIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Inventari i instrumenteve financiare në Shqipëri pasqyron atë që përmendëm dhe më sipër: ecurinë gjatë tranzicionit të sektorit financiar, të tregjeve, të biznesit në përgjithësi, etj..

Duke ju referuar periudhës tetëvjeçare, risia e vetme ka të bëjë me korrikun e vitit 1994, muaj që përkon me emetimin, për herë të parë të bonove të thesarit.

Që nga ajo kohë e deri më sot lista e instrumenteve financiare të përdorura në Shqipëri ka mbetur e njëjtë. Kjo (varfëri në lloje) favorizohet nga mungesa e tregut të letrave me vlerë, e tregut të kapitaleve, prania e një tregu të pazhvilluar monetar dhe ndërbankar etj..

Aktualisht, në dokumentet statistikore identifikohen këto instrumente financiare:

Paraja në qarkullim		
Depozitat	Të transferueshme Depozita të tjera	Klasifikimi sipas sektorëve dhe sipas kriterit të rezidencës
Letra me vlerë të borxhit	Bono thesari	Terma të ndryshëm maturimi
Kredi	Nga BPD për individët Nga BPD për biznesin Marrëveshje të riblerjes Kredi për qeverinë	Terma të ndryshëm maturimi; klasifikim sipas sektorëve dhe kriterit të rezidencës
Ari monetar		
SDR		
Të tjera për t'u marrë dhe për t'u paguar	Marrëdhëniet e BSH me institucione ndërkombëtare financiare Marrëdhëniet midis BPD	
Aksione dhe kapital tjetër	Pjesëmarrje në kapital i BPD	

Siç shihet, mungojnë instrumente të tilla si: kontratat *options* dhe *forward*, derivatet, garancitë, angazhimet etj.. Ndërkohë dhe në kolonën e dytë ka mungesa të mëdha sidomos përmendim rrallësinë e instrumenteve në zërin "letra me vlerë të borxhit" ku veçojmë kambialet, obligacionet, letrat tregtare, çertifikatat e depozitave të tregtueshme, dëftesat dhe obligacionet qeveritare etj.. Edhe në zërin e kredive, rrallësia në lloje është e dukshme.

Bie në sy mungesa e huave për kreditkartat, e kredive të hipotekës, e qirave financiare, e kredive tregtare, e kredive që financojnë blerjen e letrave me vlerë, e kredive nga investimet e huaja direkte për filialet e tyre në Shqipëri etj.. Edhe zëra të tillë si "aksione dhe kapitale të tjera" përfaqësojnë raste të rralla, duke mos treguar prirjen e përgjithshme.

2.3 PËRPILIMI I SMB-VE, KONCEPTE DHE PRINCIPE TË TJERA

2.3.1 Praktikë e përgatitjes

Përgatitja e SMB-ve në Bankën e Shqipërisë është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Sektorit të Informacionit (një njësi kjo e krijuar rreth një vit më parë⁶). Ky sektor konsolidon të dhënat e marra nga furnizuesit zyrtarë, të cilët janë: Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave, Departamenti i Operacioneve Monetare pranë Bankës së Shqipërisë dhe të gjitha bankat tregtare të licencuara nga ana e Bankës së Shqipërisë. Fillimisht ndërtohet bilanci kontabël i konsoliduar i bankës qendrore dhe ai i konsoliduar për bankat tregtare, më tej përpilohen llogaritë e autoritetit monetar, llogaritë e bankave paradepozituese dhe së fundi gjendja monetare.

Bilanci kontabël i Bankës së Shqipërisë zakonisht është i disponueshëm me një vonesë prej pesë ditësh pune pas fundit të muajit raportues. Hartimi i llogarive të autoritetit monetar zakonisht kërkon një periudhë njëjavore. Përgjashtim bën fundi i vitit, i imponuar nga mbyllja e vonuar e llogarive të buxhetit të shtetit.

Bilancet kontabël të bankave tregtare janë zakonisht të disponueshme me një vonesë prej 25 ditësh pas fundit të muajit raportues, ndërkohë që konsolidimi i llogarive të BPD merr, nga ana e tij, një periudhë tjetër dyjavore. Të gjitha të dhënat nga ana e bankave tregtare bëhen të disponueshme nëpërmjet formularëve të sistemit raportues.

2.3.2 Sistemi Raportues

Për të qartësuar më mirë bankat tregtare për sasinë dhe cilësinë e informacionit, që ato duhej të sillnin në Bankën e Shqipërisë, u përgatit një numër pasqyrash, të cilat së bashku me bilancin analitik kontabël dhe bilancin valutor formuan një lidhje të vetme, që u quajt sistemi raportues.

Kontestimet e para, nga ana e bankave tregtare, nuk vonuan dhe ato kishin të bënin me një lloj dublimi të pasqyrave të këtij formati me ato, që kërkoheshin nga Departamenti i Mbikëqyrjes. Nga ana tjetër, edhe informacioni i kërkuar për disa tregues konsiderohej i pamundur për vetë manualët kontabile, që aplikoheshin nga bankat. Duhet pranuar se reagimi i Bankës së Shqipërisë ka qenë shumë fleksibel, duke çuar në rishikime të herëpashershme të sistemit raportues, duke synuar unifikimin e kërkesave të saj pavarësisht se konsumator do të ishte DPM apo DMB. Një ndihmesë të madhe në këtë drejtim dha zbatimi i planit të ri të llogarive nga ana e bankave tregtare.

Ky plan, me pesë nivelet e tij të kodifikimit, krijon të gjitha hapësirat për identifikimin e saktë të sektorëve dhe të të dhënave, që i nevojiten DMB. Për ta mbyllur dhe me këtë çështje mendoj se prononcimi i bankave tregtare do të jetë shumë i dobishëm dhe mendoj se tribuna e kësaj konference është vendi i duhur për të diskutuar edhe një herë këtë problem.

2.3.3 Vlerësimi i Instrumenteve Financiare

Kreditë dhe depozitat regjistrohen në vlerën nominale të kontratave. Bonot e thesarit, të mbajtura në portofolin e Bankës së Shqipërisë, janë të vlerësuara me vlerën nominale. Për bankat tregtare, investimet në letra me vlerë regjistrohen për vlerën e tyre të blerjes përjashtuar kostot dhe nuk rivlerësohen deri në riblerje. Në të dhënat e kontabilitetit nuk llogariten provigjone kundrejt humbjeve të parealizuara të kapitalit.

Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen me vlerën e blerjes përfshirë kostot dhe ndonjë interes të përlllogaritur. Në secilin nga dokumentet kontabël, letrat me vlerë janë vlerësuar me çmimet më të fundit të tregut. Letrat me vlerë, të vlefshme për t'u shitur, regjistrohen me çmimin e blerjes minus kostot. Çmimi i tregut i referohet çmimit më të fundit të negociuar për letrat me vlerë të listuara dhe çmimit më të mundshëm të negociuar për letrat me vlerë të palistuar.

2.3.4 Vlerësimi i Instrumenteve të Shprehura në Monedhë të Huaj

Pozicionet në valutë të huaj janë të rivlerësuara me përqindjet zyrtare të këmbimit, të cilat, nga ana e tyre, janë të bazuara mbi normat e tregut. Pozicionet me FMN-në rivlerësohen çdo muaj duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të lekut me SDR-në, që i takon fundit të periudhës. Ari rivlerësohet çdo muaj duke përdorur çmimin e mbylljes në Ankandin e Londrës për Lingotat Metalike (LBMA) që i takon fundit të periudhës dhe kursin zyrtar të këmbimit dollarë amerikanë/lekë.

2.3.5 Vlerësimi i Aktiveve Fikse

⁶ Deri në atë moment përpilimi ka qenë ekskluzivitet i DPM.

Aktivitet fikse janë të regjistruara me çmimin e blerjes dhe nuk rivlerësohen. Megjithatë, të gjitha aktivitet fikse, përveç tokës dhe aktiveve, vlera e të cilave nuk ulët me kalimin e kohës, janë të amortizueshme.

2.3.6 Provigjonet

Në përgjithësi, provigjonet kërkohen sa herë që vlera aktuale e një aktivi bëhet më e ulët se vlera e tij kontabile. Për bankat tregtare, huatë klasifikohen në kategori të ndryshme (standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura) në varësi të cilësisë së rrezikut të kredisë, i cili rishikohet të paktën një herë në tre muaj. Provigjoni për riskun statistikor llogaritet mbi huatë standarde dhe ato në ndjekje. Ndërkohë, për kreditë nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura, provigjonet llogariten të veçanta. Provigjonet kundrejt ndonjë humbjeje të kapitalit llogariten për çdo grup homogjen të letrave me vlerë. Gjithashtu, provigjone llogariten edhe për garancitë e lëshuara apo për angazhimet. Të gjitha provigjonet llogariten sipas rregullores së mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Në gjendjen monetare provigjonet janë të përfshira në llogarinë kapitale.

2.4 PUBLIKIMI

Ndryshe nga përgatitja, publikimi i SMB-ve, është një përgjegjësi e shpërndarë në disa njësi administrative të Bankës së Shqipërisë.

Dokumenti bazë statistikor, që përgatitet nga Banka e Shqipërisë (Sektori i Informacionit), quhet **Gjendja Monetare**, një publikim periodik mujor, në të cilin përfshihen:

- a) Paraqitja e Statistikave Monetare dhe të Bankave⁷.
 - i. Gjendja monetare sipas IFS
 - ii. Autoriteti Monetar
 - iii. BPD
- b) Paraqitja e zhvillimeve monetare sipas modelit të ri të SMB-ve.
 - i. Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë
 - ii. Paraqitja monetare e bankës qendrore
 - iii. Bilanci sektorial i BPD
 - iv. Paraqitja monetare e BPD
 - v. Paraqitja e ngushtë monetare
- c) Faqja e SMB në IFS – formularët 01 dhe 06 (botim i FMN-së).

Përdorimi i këtij raporti është i kufizuar brenda vetë Bankës së Shqipërisë dhe në Departamentin e Statistikave të FMN-së, dhe publikimi i tij bëhet rreth një muaj pas datës së fundit të periudhës raportuese. Në fakt, ky produkt statistikor shërben si bazë për hartimin e publikimeve të tjera (Raporti Statistikor Mujor, Faqja e Shqipërisë në IFS, etj.) dhe për qëllime të analizës dhe të procesit të vendimmarrjes.

Publikimi i të dhënave për publikun realizohet nëpërmjet Raportit Statistikor Mujor (RSM⁸), i cili është i disponueshëm kundrejt një kërkesë formale nga çdo i interesuar.

Deri në fund të muajit gusht 2000, informacioni i paraqitur në RSM përmban të dhëna të agreguara për pikën (a) të mësipërme si dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me interesin, depozitat, kredinë, kursin e këmbimit dhe të dhëna nga ekonomia. Parimi i hartimit të tij qëndron në pasqyrimin e informacionit në dy pjesë: të dhëna me frekuencë vjetore (vitet e tranzicionit) dhe të dhëna me frekuencë mujore (12 muajt e fundit).

Kohët e fundit, Banka e Shqipërisë ka prezantuar informacionin statistikor edhe në Faqen e saj në Internet, në adresën www.bankofalbania.org. Përveç informacionit statistikor është pasqyruar dhe shpjeguesi metodologjik për çdo tregues. Principi bazë, në këtë rast, qëndron në publikimin e të dhënave me frekuencë mujore që nga momenti, që ato kanë filluar të monitorohen.

⁷ Paraqitja e SMB-ve bëhet sipas "Metodikë për paraqitjen e gjendjes monetare" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 11, datë 21.09.1994.

⁸ Në fakt, RSM përgatitet në datën 25 të çdo muaji, por lista e konsumatorëve të tij ka diapazonin e saj të plotë në fund të çdo tremujori kur raporti është pjesë përbërëse e Buletinit Ekonomik. Kuptohet që në muajt e tjerë numri i përdoruesve është më i ulët: kryesisht bankat tregtare, njësi qendrore të qeverisë, komisione parlamentare, institucione ndërkombëtare, etj..

Që nga shtatori 1996, Republika e Shqipërisë ka faqen e saj në botimin e Fondit, International Financial Statistics (IFS). Megjithë specifikat e ndryshme, që kanë ekonomitë e ndryshme, kur i referohemi publikimit IFS, përnjëherësh mund të krahasojmë treguesit e vendit tonë me të çdo vendi tjetër.

Është kjo lehtësi që ofrohet nga ky botim, që bën unifikimin e “gjuhës” së statistikave në një të vetme. Publikimi i të dhënave në këtë botim ka ecur në mënyrë të rregullt përjashtuar disa muaj në gjashtëmujorin e parë të vitit 1997, ku pati çrregullime si në afate ashtu dhe në cilësinë e të dhënave.

Së fundi, kushdo i interesuar mund të mësojë më shumë rreth SMB-ve duke u konsultuar nëpërmjet Sistemit të Përgjithshëm të Publikimit të të Dhënave (GDDS), një sistem elektronik i ndërtuar po nga FMN-ja. Që prej disa muajsh, kushdo që ka akses në Internet, në adresën dsbb.imf.org/gddsweb/country/albfinindex.htm, mund të mësojë për llojin, metodologjinë e hartimit, cilësinë, kohën e përgatitjes, mënyrën e publikimit, etj., të SMB-ve në Shqipëri.

Për të dyja opsionet e fundit duhet pranuar se, megjithëse Banka e Shqipërisë zë peshën kryesore të informacionit dhe ka qenë institucioni korrespondent nga ana e palës shqiptare, informacioni i siguruar është kombëtar dhe në të dyja rastet referimi i bëhet Shqipërisë. Të dyja rastet e mësipërme tregojnë dhe një fakt tjetër atë të bashkëpunimit të suksesshëm ndërinstitucional.

3. E ARDHMJA

Në këtë fillim mijëvjeçari duket se sfidat e të ardhmes, më së shumti, nënkuptojnë maksimizim të përfitimeve nga teknologjia dhe informacioni. Të gjithë jemi dëshmitarë se megjithë vonesën “e natyrshme” në fillim të viteve '90, vitet e fundit kanë shënuar zhvillime të mëdha edhe në vendin tonë si përsa i përket anës së teknologjisë së informacionit, ashtu dhe anës aplikative. Nën këtë këndvështrim kam përshtypjen se qëndrojnë dhe sfidat më të mëdha të Bankës së Shqipërisë në fushën e statistikave të parasë dhe të bankave.

- Tashmë ka ardhur koha që Banka e Shqipërisë të ketë një bazë të dhënash financiare. Në funksion të këtij objektivi është dhe krijimi i Sektorit të Informacionit, i cili është ideuar që në të ardhmen e afërt të jetë njësi administrative e Bankës së Shqipërisë, e cila do të shtojë, të ruajë dhe do të administrojë këtë bazë të dhënash. Baza e të dhënave do të përfshijë si të dhënat për SMB-të ashtu edhe për ato të mbikëqyrjes bankare.
- Ndërtimi i bazës së të dhënave do të krijojë premisat për ngritjen e një rrjeti lokal informacioni si dhe zbatimin e një rrjeti komunikimi të dhënash të integruara me bankat tregtare, duke kontribuar në rritjen e efektivitetit të tregut ndërbankar dhe në përmirësimin e publikimit të të dhënave.

Dy objektivat e mësipërm, parë nga këndvështrimi i maturitetit, përkojnë me detyra të një perspektive më afatgjatë, ndërkohë që momenti evidenton disa përparësi të tjera, të cilat do t'i listonim si më poshtë:

- Kalimi nga statistika monetare dhe të bankave në statistika monetare dhe financiare. Ndonëse në dukje tingëllon pak si lojë fjalësh, ky objektivi ka të bëjë me përfshirjen në statistika të të gjitha institucioneve financiare, pasi zhvillimi i sektorit financiar mund të jetë shumë i shpejtë dhe nuk do të jetë si aktualisht ku kemi vetëm 3 shoqëri sigurimesh, 6 shoqëri kursim - krediti, 3 fonde kursimesh inoperative, etj.. Në këtë kontekst, hap i parë do të jetë korrigjimi i legjislacionit për shoqëritë kursim - kredi, ku do të kërkohet mbikëqyrja dhe raportimi i tyre i detyruar në Bankën e Shqipërisë. Përbushja e këtij objektivi do të krijonte premisat për të aplikuar pranë FMN-së për anëtarësimin e Shqipërisë në Sistemin e Shpërndarjes të Dhënave Speciale (SDDS).
- Disa herë më sipër është përmendur dualiteti i dy manualeve të përpilimit të SMB-ve. Pavarësisht kësaj, Banka e Shqipërisë, që nga tremujori i dytë i vitit 1999, po përpilon dokumentet e saj statistikore në të dyja formatet. E ardhmja nënkupton një rishikim total të terminologjisë së përdorur në të gjitha publikimet e saj për ta bërë konsistente atë me manualin e ri të hartimit të statistikave monetare dhe financiare. Kjo nënkupton hartimin e një metode të re të hartimit të SMF në Shqipëri, proces ky që do të zyrtarizonte *de jure* prodhimet statistikore të Bankës së Shqipërisë në përputhje me manualin e ri të FMN-së.
- Megjithë shkallën e kënaqshme të asimilimit të planit të ri të llogarive nga ana e bankave tregtare, Banka e Shqipërisë gjykon se problemet, që janë evidentuar do të zbehen ndjeshëm në qoftë se do të përgatitet një manual i detajuar i funksionimit të planit të ri kontabël.
- Banka e Shqipërisë është shumë e ndjeshme për ndërtimin e një kanali komunikimi sa më efektiv ndërmjet saj dhe bankave tregtare. Në këtë aspekt po shihet mundësia e raportimit nëpërmjet email-

it nga ana e bankave tregtare (kjo praktikë raportimi ka rezultuar e efekshme në raportimin që bëhet në FMN).

Në përfundim, dua edhe një herë të përsëris që shkalla e impenjimit të përbashkët ka qenë maksimale. Ajo nuk shpjegohet me interesa financiarë të punonjësve dhe as me ambicje për të ngjitur shkallë të hierarkisë bankare; ajo është thjesht pjesë e “çudisë” së mendjes dhe karakterit shqiptar, pjesë e shpirtit dhe e edukatës; pjesë e krenarisë së secilit prej nesh; mbi të gjitha është dashuri për profesionin.

4. LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA:

BPD	Bankat Paradepozituese
DMB	Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
DPM	Departamenti i Politikës Monetare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDDS	General Data Dissemination System
IFS	International Financial Statistics
INSTAT	Instituti i Statistikave
LBMA	London Bullion Metal Auction
SDDS	Special Data Dissemination System
SDR	Special Drawing Rights
SMB	Statistikat Monetare dhe të Bankave
SMF	Statistikat Monetare dhe të Financave
RSM	Raporti Statistikor Mujor